



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2143 Prot.

Tiranë, më 17.09 2025

VENDIM QARKULLUES

Nr. 108 Datë 17.09 2025

PËR

**MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME
STAF AKADEMIK PËR TRE NJËSITË KRYESORE TË UNIVERSITETIT TË
SPORTEVE TË TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026**

Në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma (ç), të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", në VKM me nr.123, datë 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës" në VKM me nr. 243, datë 20.04.2023 "Për një ndryshim në VKM nr. 748, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të Arsimit të Lartë", në VKM me nr. 329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik", në Udhëzimin e MASR me nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet publike të Arsimit të Lartë", në shkresën e Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes me nr. 2008/1 prot., datë 12.09.2025 "Kërkesë për personel akademik të jashtëm për vitin akademik 2025-2026 në FSHL", në shkresën e Dekanit të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit me nr. 2008/3 prot., datë 15.09.2025 "Planifikimi për personel akademik me kohë të pjesshme pranë FVFR, për vitin akademik 2025-2026", në shkresën e Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit me nr. 2008/2 prot., datë 12.09.2025 "Planifikimi për personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2025-2026", në FSHR-së", Senati Akademik në mbledhjen e radhës,

V E N D O S I:

Miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme staf akademik për tre njësitë kryesore të Universitetit të Sporteve të Tiranë, për vitin akademik 2025-2026, si më poshtë:

- | | |
|--|------------|
| 1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme staf akademik FSHL | 13 persona |
| 2. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme staf akademik FVFR | 6 persona |
| 3. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme staf akademik FSHR | 14 persona |

4. Efektet financiare mbulohen nga granditë e ardhura nga MAS dhe të ardhurat e Universitetit.
5. Ky vendim t'i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të UST.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES
DEKANI**

Nr. 2008 / Prot.

Tiranë, më 12.09.2025

Lënda: Kërkesë për personel akademik të jashtëm për vitin akademik 2025-2026 në FSHL

**REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
PROF.DR. AGRON KASA**

Në përgjigje të shkresës nr. 2008 prot, dt. 03.09.2025 “Kërkojmë planifikimin e personelit akademik të jashtëm”, si dhe në zbatim të Udhëzimit nr. 29, dt. 10.09.1918 të MAS, në Statutin dhe Rregulloren e UST, ju bëjmë me dije se për mbarëvajtjen e procesit mësimor për vitin akademik 2025-2026, FSHL planifikon të rekrutojë **13 (trembëdhjetë)** personel akademik të jashtëm.

Faleminderit për mirëkuptimin.

DEKANI

Dr. Orkida KOSTA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT
DEKANI

Nr. 2008 Prot.

Tiranë, më 15.09. 2025

Lënda: Planifikimi për personel akademik me kohë të pjesshme pranë FVFR për vitin akademik 2025- 2026

REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
PROF. DR. AGRON KASA

I nderuar Z. Rektor!

Mbështetur në Ligjin 80 / 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH”, në Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 të MAS, në Rregulloren dhe Statutin e UST-së, si dhe në shkresën tuaj me Nr. 2008 Prot., datë 03.09.2025; Ju bëjmë me dije se numëri i personelit akademik me kohë të pjesshme i planifikuar për tu angazhuar në mësimdhënie pranë Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, për vitin akademik 2025-2026, është 6 (gjashtë).

Duke ju faleminderuar për bashkëpunimin!

DEKANI

Prof. Asc. Dr. Elton SPAHIU





REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT
DEKANI

Nr. 2008/12 Prot.

Tiranë, më 12.09.2025

Lënda: Planifikim për personel akademik me kohë të pjesshëm për vitin akademik 2025-2026 në FSHR.

REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
PROF. DR. AGRON KASA

I Nderuar Z. Rektor!

Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 2008 Prot., datë 03.09.2025, "Kërkojmë planifikimin e personelit akademik të jashtëm", si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL" të MAS, të Statutit dhe të Rregullores së UST, ju bëjmë me dije se Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe për mbulimin e moduleve përkatëse në programet e studimit që ofron, planifikon të angazhojë 14 (katërmëdhjetë) pedagogë si personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2025-2026.

DEKANI
Prof. Dr. Robert ÇINA

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/DEKANI
Dr. Aisel OSEKU

